

Projekti: ArtEd – Rritemi përmes Artit në Arsimim

RAPORTI I VLERËSIMIT TË TRAJNIMIT ONLINE “DIZAJNIMI I KOSTUMEVE”

Me qëllim të plotësimit të njohurive dhe shkathtësive të nxënësve në shkollat kampione, u organizua trajnimi online për dizajn të kostumeve, me 40 nxënës të talentuar. Është menduar që nxënësit pjesëmarrës, pas trajnimit, të mbështesin klubet teatrale në krijimin e performancave, gjegjësisht me dizajnin e kostumeve sipas skenarit dhe regjisë përkatëse.

Koncepti i trajnimit është hartuar në bashkëpunim me dizajneren Njomëza Luci, e cila ka përpiluar programin e detajuar.

Përmes pyetësorëve të dizajnuar online (në Google form) është bërë edhe vlerësimi i trajnimit, me ç’rast janë plotësuar pyetësorët nga të gjithë nxënësit pjesëmarrës, menjëherë pas përfundimit të trajnimit.

Rezultatet e vlerësimit dhe konkluzionet

- Numri total i përgjigjeve individuale – 40
- Pyetësorët janë plotësuar në Google format
- Rezultatet janë nxjerrë dhe prezantuar në formë grafike
- Përgjigjet e dhëna me shkrim, janë përmbledhur dhe prezantuar nën pyetjet përkatëse

1. Si e vlerësoni këtë lloj trajnimi për zhvillimin e shkathtësive të juaja?

Me 5 (vlera maksimale) janë përgjigjur – 97.5%

Me 4 janë përgjigjur – 2.5%



Implemented by:



1
In cooperation with:



40 responses

Accepting responses


Summary

Question

Individual

1. Si e vlerësoni këtë lloj trajnimi për zhvillimin e shkathtësive të juaja ?

40 responses



2. A do te preferonit ndonje platforme tjetër online për trajnime? Nese po, cilen dhe pse?

Përgjigjet:

- Organizimi i trajnimit në klasë
- Platforma Zoom është zgjidhje perfekte
- Nuk do të preferoja ndonjë platformë tjetër
- Zoom është praktik dhe i lehtë për tu përdorur
- Zoomi është i përshtatshëm për këto lloj trajnimesh
- Mënyra më e mirë për trajnime online është platforma Zoom
- Platforma Zoom ishte mjaft funksionale dhe pa probleme
- Zoom ka qenë në rregull si dhe ka mundësinë e "share screen"
- Zoom është platforma e duhur për këtë trajnim për shkak edhe të virusit (Covid 19)
- Platforma - Google Meet, sepse koha e takimit nuk është e limituar
- Më mirë do ishte të mbahet trajnimi me prezencë fizike, me të gjithë nxënësit

2

In cooperation with:




Implemented by:



A do të preferonit ndonjë platformë tjetër online për trajnime? Nëse po, cilën dhe pse?


40 responses



3. A ju kane mjaftuar materialet e ofruara per trajnim?

A ju kanë mjaftuar materialet e ofruara për trajnim?

40 responses



4. A do te kishit shtuar ndonje material tjetër, bazuar ne programin e trajnimit?

Përgjigjet:


- Materiale tjera: si tekstil, dekoruese, etj

- Një laps-kimik të bardh, dhe një të zi, të posaçme për vizatime
- Të mjaftueshme; kanë qenë të gjitha materialet e nevojshme
- Imagjinata nuk ka kufij, sado që të kemi imagjinatë, aq më shumë na duhen materiale
- Nuk do kisha shtuar asgjë, sepse ideja nuk është vetëm të kemi materiale të gatshme por edhe të mësohemi t'i krijojmë vetë ato, gjë që na zhvillon kreativitetin, dhe na duhet në të ardhmen

A do të kishit shtuar ndonjë material tjetër, bazuar në programin e trajnimit? Nëse po, listoni më poshtë:




40 responses



5. A ka qenë i kuptueshem programi i trajnimit?

A ka qenë i kuptueshëm programi i trajnimit?

40 responses



4

In cooperation with:



Implemented by:



6. A janë dhënë instruksione të qarta për të kryer detyrat praktike?

A janë dhënë instruksione të qarta për të kryer detyrat praktike?

40 responses



7. Çfare kishit shtuar/ndryshuar apo larguar nga dy sesionet e programit?

Përgjigjet:

- Të gjitha kanë qenë të spjeguarra gjersisht, dhe shumë të kuptueshme
- Të shtohen edhe pak minuta, jemi argetuar shume, ora është kryer shpejtë
- Mua më pëlqeu dhe nuk do të kisha shtuar apo ndryshuar asgjë
- Të kishim më shumë sesione, përpos këtyre dy sesonave
- Kisha shtuar edhe qepjen e ndonjë maske për mbrojtje nga Covid-19
- Më pëlqeu përzgjedhja që kemi pasë për detyrë të bëjme. Por, do të kisha pasë dëshirë të bënim edhe ndonjë shfaqje, shembull: me maskat që po i realizojme tani
- Do të kisha dashur që takimet të ishin me të gjata, sepse ka pasur raste kur për të mos e kaluar kohen e trajnimit kemi mbetur në gjysme, në disa gjera

5

In cooperation with:



Implemented by:



Çfarë kishit shtuar/ndryshuar apo larguar nga dy sesionet e programit?




40 responses



8. Sa keni arritur te fitoni njohuri me kete trajnim?

Sa keni arritur të fitoni njohuri me këtë trajnim?

40 responses



9. A mendoni qe njohurite e fituara mund ti aplikoni ne klubin e teatrit ne shkollen tuaj?



Implemented by:




6
In cooperation with:



A mendoni që njohuritë e fituara mund ti aplikoni në klubin e teatrit në shkollën tuaj?

40 responses



10. Çfarë lloj trajnim tjetër i mungon nivelit tuaj edukativ? Ju lutem përshkruani idenë tuaj

Përgjigjet:

- Punimi i gjërave kreative
- Zhvillimi i mendimit kritik
- Trajnim më i avancuar me argjilë
- Trajnim për skenar dhe skenografi
- Trajnim për ngritje të vetëbesimit
- Aktrim, muzikë, art, operë, muzika të ndryshme, balet, teatër, etj
- Trajnim në lidhje me rrespektin për njeri-tjetrin
- Trajnim për regji, skenografi apo skenare nga ata që veç e ushtrojnë këtë profesion
- Sa i përket kostumografisë, do të ishte akoma më mirë sikur këto mësimë që po i marrim të kemi mundësinë të praktikojmë edhe kur kemi shfaqje me ArtEd.
- Me vazhdu me kësi lloj trajnime për Kostumografi sepse është ART i vërtetë!
- Një shfaqje e vogël me maskat që po realizojmë, ose edhe me vizatimet dhe skicat tona, po edhe ndonjë veshje shembull nga dizajni im dhe qepja e prindërve
- Mbrojtaj ndaj mjedisit - që të arrijmë të ndryshojmë diçka në mjedisin tonë, e jo vetëm të japim ligjerata - që besoj edhe në libra të ndryshëm shkollor mundemi me i lexu. P.sh. për mbrojtjen e mjedisit nga plastika

7

In cooperation with:


Implemented by:

- Të sfidohehi të bejmë vetë kostumet tona me buxhet të caktuar, duke përdorur ato që kemi mesuar, dhe të rikrijojme diçka që mund të na ndodhë nëse marrim pjese në një film apo shfaqje më të madhe në të ardhmen.

11. Si e vlerësoni ligjeratën e trajneres Njomeza Luci?

Si e vlerësoni ligjeratën e trajneres Njomeza Luci?

40 responses



KONKLuzionet nga Rezultatet e Vlerësimit

1. Në përgjithësi, nxënësit (rreth 98% e tyre) e shohin si të nevojshëm, trajnimin e ofruar për zhvillimin e shkathtësive të tyre, me vlerë maksimale (5).

2. Nxënësit kanë vlerësuar se platforma Zoom është e përshtatshme për mbajtjen e trajnimeve online, meqë është lehtë për tu përdorur, praktike dhe ka mundësinë për të ndarë informata (share screen). Por, ka disa prej tyre që kanë sugjeruar përdorimin e platformës falas “Google meet” – si alternativë, për shkak se nuk ka kohë të kufizuar (përderisa Zoom ofron vetëm 40 min për një seancë, dhe pastaj duhet ndërprerë për të caktuar takimin e ri). Ka dhe prej sosh që kanë preferuar që trajnimi të ishte mbajtur në klasë, dhe me prezencë fizike, në mënyrë që nxënësit të kishin mundësi të komunikimit të drejtpërdrejtë dhe bashkëpunimit.

3. Sa i përket materialeve të trajnimit, nëse kanë qenë të mjetueshme nxënësit kanë vlerësuar se kanë mjaftuar për detyrat praktike, të cilat u janë dhënë gjatë trajnimit. Disa prej tyre kanë cekur se do të kishin shtuar edhe materiale tekstili, materiale dekoruese me vizëllima, lapsa me ngjyrë për vizatim, etj. Përderisa, njëri prej tyre ka sugjeruar që mund t'i krijojnë edhe vetë ato, dhe në këtë mënyrë të zhvillojnë kreativitetin e tyre.

4. 100% e nxënësve kanë vlerësuar se programi i trajnimit ka qenë i kuptueshëm, dhe se instruksionet kanë qenë të qarta për të kryer detyrën praktike.

5. Në pyetjen se çfare kishit shtuar/ndryshuar apo larguar nga dy sesionet e programit, nxënësit janë përgjigjur në disa raste se do të kishin rritur kohëzgjatjen e sesioneve, ose të shtohen më shumë pjesë të trajnimit – sesionet, sepse në disa raste, për të mos e kaluar kohen e trajnimit, kanë mbetur në gjysme disa gjëra. Disa nxënës kanë shprehur dëshirën që të realizojnë ndonjë shfaqje – ku do të mund t'i përdornin dizajnet e tyre, p.sh të maskave dhe kostumeve të krijuara gjatë dhe pas trajnimit.

6. Nga gjithsej 40 nxënës pjesëmarrës, 80% kanë vlerësuar se kanë arritur të fitojnë njohuri të reja përmes këtij trajnimi (vlerësim maksimal 5), 15% e tyre kanë vlerësuar se kanë arritur të fitojnë njohuri mjaftueshë (4), ndërsa 5% e tyre kanë vlerësuar mesatarisht (3) që nënkupton se nuk kanë arritur të fitojnë njohuri të mjaftueshme apo të mangëta, çoftë për shkak të kohës së shkurtë, apo paqartësisë në marrjen e informatave. Përderisa, 100% e nxënësve mendojnë se njohuritë e fituara do të mund t'i aplikojnë në Klubin e Teatrit në shkollat e tyre.

7. Në pyetjen së çfarë lloj trajnim tjetër i mungon nivelit tuaj edukativ, një pjesë e madhe e nxënësve kanë shprehur dëshirën për të pasur trajnime edhe në fushat e tjera të artit dhe kinematografisë si: aktrim, muzikë, operë, muzikë, Balet, teatër, etj. Gjithashtu, ata preferojnë të kenë edhe një trajnim për skenar dhe skenografi nga profesionistë të kësaj fushe.

Ka pasur edhe propozime për trajnime të llojit si: zhvillimi i mendimit kritik, trajnim për ngritje të vetëbesimit apo në lidhje me rrespektin për njeri-tjetrin. Sa i përket kostumografisë, kanë vlerësuar se do të ishte mirë sikur këto njohuri të marra të mund t'i praktikojnë tek shfaqjet me ArtEd. Një prej tyre ka sugjeruar edhe një trajnim për mbrojtje ndaj mjedisit – për të ndryshuar diçka në mënyrë konkrete në mjedisin ku jetojmë.

8. Të gjithë nxënësit (100%) kanë dhënë vlerësim maksimal (%) në lidhje me mënyrën e ligjërimit dhe trajnimin e realizuar nga dizajnerja - Njomeza Luci.

Disa nga komenetet e përzgjedhura rreth kësaj janë përshkruar më poshte:

- Përvoja ime në përgjithësi ka qenë e shkelqyer dhe kam ndjerë një rehati në trajnim sepse trajneret na kanë mbështetur emocionalisht, duke na thënë se asnjë pyetje nuk është e gabuar dhe se duhet të ndjehemi të lirë të shprehim çdo paqartësi
- Mbështetja e jashtëzakonshme që më ka dhënë personalisht trajnerja Njomeza Luci, duke më dhënë vetëbesim dhe kurajo për të bërë atë që dua. Ajo me aftësinë për të kuptuar secilin nxënës në trajnim, ka treguar përkushtim për të na udhëzuar për çdo gjë, dhe si t'i bëjmë gjërat akoma më mirë.